



Prof.Ass.Dr.Florim Grajçevci
Dekan

Ref. nr. 155/A Prishtinë 20.01. 2023

Duke u mbështetur në Statutin e Universitetit të Prishtinës, neni 222 deri 225 lidhur me Raportin e Punës dhe përbushjes së detyrimeve, si dhe Vendimit të miratimit të raportit vjetor të Këshillit të Fakultetit të datës 19 janar 2023, Dekani i Fakultetit të Ndërtimtarisë sjellë:

Raport i Punës dhe i Pëmbushjes së detyrave për periudhën janar-dhjetor 2022.

Fakulteti i Ndërtimtarisë si njësi akademike e Universitetit të Prishtinës gjatë periudhës janar dhjetor 2022 ka zhvilluar një seri aktivitete të cilat mund të klasifikohen në aktivitete të rëndomta të funksionimit si dhe në aktivitete tjera të cilat kanë për qëllim përbushjen e strategjisë së Universitetit të Prishtinës, përkatësisht të Fakultetit të Ndërtimtarisë sikur janë bashkëpunimet me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizimi i ligjëratave të hapura, tryezave të punës dhe të tjera.

Misioni i FN-së është i bazuar në misionin e Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e veprimeve akademike, hulumtimeve, punës shkencore dhe të krijojë kuadro profesionale të arsimit të lartë për tregun e punës për fushat e inxhinierisë së ndërtimit në pajtim me interesat strategjike dhe zhvillimore të vendit.

Mësimdhënia dhe kërkimet shkencore, paraqesin veprimtarinë kryesore të kësaj njësie akademike. Veprimtarinë e një njësie akademike e karakterizon bashkëveprimi ndërmjet veprimtarisë mësimdhënëse dhe asaj kërkimore-shkencore. Kjo, për faktin se, për arritjen e rezultateve të dëshiruara në studime, mësimdhënia duhet të jetë e pa ndarë nga puna kërkimore shkencore.

Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Ndërtimtarisë për periudhën 2021-2023 i miratuar nga Këshilli i Fakultetit dhe i publikuar në faqen elektronike përcakton qëllimet e arritjeve institucionale për periudhën e janar-dhjetor 2022, me prioritetet:

- Rritjen e vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Përmirësimin dhe shtimin e rritjes së kapaciteteve të stafit akademik dhe ambienteve të mësimi.
- Rritjen e cilësisë për shërbimet e studentëve.
- Promovimin dhe rritjen e standardeve të cilësisë për programet e studimeve.
- Ngritjen e kapaciteteve të Laboratorëve për fushat profesionale shkencore.
- Avancimin e kërkimeve dhe hulumtimeve shkencore në nivele ndërkombëtare.

Vizioni i FN-së është të krijojë, të zhvillojë, të mbrojë dhe të transmetojë njohuri përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore, po ashtu të ofrojë mundësi për të gjithë banorët e Kosovës për të përfituar nga ky arsim gjatë gjithë jetës së mësimi tërë jetësor pa kufizime.

Në këtë mënyrë niveli universitar i studimeve në njësi akademike arrin të parapërgatitë studentë për t'u përshtatur mirë dhe shpejt në pozicione bazë në tregun e punës. Njëkohësisht, niveli universitar krijon premisa të mira për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta, përmes njohurive lehtësisht transferuese në disiplina të përafërta.

Fakulteti i Ndërtimtarisë funksionon në mënyrë të organizuar sipas organogramës së treguar më poshtë.




Figura 1. Organograma e Fakultetit të Ndërtimtarisë

Faqja elektronike e Fakultetit të Ndërtimtarisë <https://fn.uni-pr.edu/> përdytësohet dhe freskohet me informata aktuale në baza të rregullta kohore. Freskimi i publikimeve, informatave për gjithë spektrin e pedagogëve, studentëve, administratës dhe Bordin Industrial bëhet në kohë reale.

Në çdo vit akademik Fakulteti zgjedh dhe nominon studentët e dalluar për të cilët ndanë mirënjohje dhe se këta studentë publikohen në faqen elektronike të Fakultetit ndërsa në aktivitete të veçanta të njejtët student janë me prioritet të zgjedhjes. <https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,54>

Gjatë pranverës, stafi dhe administrata e FN-së është angazhuar për fushatë të sensibilizimit të maturantëve të shkollave të mesme në Kosovë. Janë organizuar takime për përgaditjen e materialeve njoftuese përkatësisht fletëpalosje me informata përmbajtjesore nga FN-ja dhe programet e studimeve të cilat organizohen nga IAL.

Sipas kërkesës dhe miratimit të këshillit të FN-ja e në pajtim me rregulloret dhe vendimin e senatit angazhohen Profesoret Vizitor për vitin akademik 2022/2023 nga Universiteti Politeknik i Tiranës, përkatësisht Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit si dhe Universiteti Teknik i Vjenës.

Duke u mbështetur në Statutin e UP-së, mbi organizimin dhe funksionalizimin e Trupës Këshillëdhënëse (Bordit Industrial) të njësive akademike, Fakulteti i Ndërtimtarisë ndihmohet nga tregu i punës lidhur me informatat e kthyer nga persona të cilët i përket kuadrit të plasuar. Si nevojë e freskimit të Bordit Industrial të FN-së janë zhvilluar negociata me shumë kompani vjetore të cilat kanë shprehë gatishmëri të jenë pjesë e Bordit.

Gjatë periudhës së këtij raporti kryesia e BI mbanë takime në baza të rregullta mujore me FN si dhe takime me BI në periudha gjashtëmujore. Së bashku me BI, FN-ja organizon ligjëratat të hapura, ndihmuan dhe mbështetën financiarisht mësimdhënësin me biletë udhëtuese, mbështetën studentët me libra të paguara nga anëtarët e Bordit.

Në vitin 2022 është inauguruar shtypja e librit “Mekanika I” e autorit A.Dautaj e dedikuar studentëve të Fakultetit të Ndërtimtarisë.

Bazuar në relacionet e krijuara ndërmjet Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe kompanisë përpiluese të Programit softverik DIANA FEA, gjatë dhjetorit 2021 dhe janar 2022 janë organizuar trajnime (5 module) për këtë program, i cili është program shumë i avancuar sa i përket fushave të Ndërtimit përkatësisht konstruksioneve. Trajnimi është organizuar online, për 20 (njëzet) studentë dhe 7 (shtatë) pjesëmarrës prej stafit akademik nga Fakulteti jonë. Pas përfundimit të trajnimeve për të gjithë pjesëmarrësit janë dhënë Certifikata të trajnimit.

Në mars të vitit 2022 në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës ka përfunduar skenimi i të gjitha librave amë - regjistruar të studentëve duke i përfshirë të gjithë librat dhe duke krijuar bankën e shënimeve elektronike të Studentëve të FN-së.

Organizimi i takimeve kolegjiale, mbledhjet e këshillit të fakultetit të Ndërtimtarisë janë organizuar duke respektuar Statutin e Universitetit së paku një takim brenda një muaji. Takimet e komisionit të studimeve janë të rregullta dhe në funksion të kërkesave nga studentët. Takimet e Departamenteve me menaxhmentit të Fakultetit janë në funksion të kërkesave të tyre dhe me baza të rregullta. Gjithashtu, pjesëmarrja e Dekanit në takimet e kolegjiumit të Dekanëve dhe Senatit janë të rregullta. Takimet e menaxhmentit të Fakultetit me Bordin Industrial të Fakultetit janë të rregullta dhe periodike në çdo muaj.

1.1 Numri i Studentëve


Numri i studentëve aktiv në nivel të Fakultetit për të gjitha programet e studimeve të niveleve BSc dhe MSc janë 1134, prej të cilëve 800 meshkuj dhe 334 femra.

Programet e studimeve Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit përbëhen nga kurrikulat të formuara nga lëndët të përgjithshme, lëndët me karakter formues profesional, lëndët integruese, profesionale, plotësuese dhe temës së diplomës (Bachelori dhe/ose Master) e cila është e bazuar në aplikimin e njohurive paraprake dhe në hulumtime paraprake.


Tabela 1 Numri i studentëve aktual në Programet Studimore

	Bachelor			Master			Total		
	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M
Konstruktiv	535	130	405	126	28	98	661	158	503
Hidroteknikë	110	22	88	54	29	25	164	51	113
Gjeodezi	177	46	131	54	24	30	231	70	161
Inxhinieri e Ambientit	75	52	23				75	52	23
Infrastruktura Rrugore				3	3	0	3	0	0
TOTAL	897	250	647	237	84	153	1134	334	800

Numri i studentëve të ri për të studiuar në programet e studimeve të Fakultetit të Ndërtimtarisë është në rënje krahasuar me vitet paraprake. Pranimi i studentëve të ri për vitin akademik 2022/2023 në të gjitha programet e studimeve në nivelin Bsc janë 146 student dhe programet e studimeve MSc janë 64 student. Kapaciteti i programeve të studimeve për studentë të ri në të gjitha programet e studimeve është 350 student, ndërsa të regjistruar për vitin akademik 2022/2023 janë gjithsej 210.



Grafiku 1. Numri i studentëve të FN-së të pranuar në pesë vitet e kaluara për studime në programet e studimeve BSc



Grafiku 2. Numri i studentëve të FN-së të pranuar në pesë vitet e kaluara për studime në programet e studimeve MSc

Për studentët e diplomuar, Alumni është krijuar bazë e shënimeve të tyre përmes pyetësorit të postuar në faqen elektronike të fakultetit dhe vazhdon edhe më tutje të plotësohet nga studentët e diplomuar.

Janë disa raste të mobilitete të studentëve nga Fakulteti i Ndërtimtarisë në institucionet Evropiane, sikur: Universiteti i Trentos, Itali; Universiteti Teknik i Munihut, Gjermani; “Poznan University of Life Sciences” Poloni; Universiteti i Gentit, Belgjikë.

Studentëve të Fakultetit ju është dhënë hapësirë në faqen elektronike të Fakultetit. Janë evidencat e Studentëve transparente të përfaqësimeve të studentëve nga Këshilli i Studentëve, përfaqësues të studentëve në Këshillin e Fakultetit, Studentët e dalluar, Puna e studentëve, Punimet e diplomave Master të Studentëve, etj.

1.2 Mësimdhënja akademike

Viti kalendarik 2022, karakterizohet me zhvillim të pa penguar të mësimit në semestrat veror dhe dimëror të viteve akademike (2021/2022 dhe 2022/2023) krahasuar me dy vitet paraprake kur mësimi ishte zhvilluar në variantin virtual duke marr parasysh efektin e pandemisë dhe infeksioneve të COVID-19.

Sipas shënimeve nga raportet e mësimdhënësve, mësimi për periudhën 15 shkurt deri 31 maj 2022 janë mbajtur gjithsej 5514^h, që mesatarisht 75,72^h/ditë pune. Ndërsa semestri dimëror fillon punën me mësim me 01 tetor dhe deri në dhjetor mësimdhënësit e FN-së mbajtën 4573^h mësim.

Tabela 2. Orët mësimore të mbajtura nga stafi akademik i rregullt, nga Universiteti dhe i angazhuar për semestrin dimëror të vitit akademik 2021/2022 për periudhën janar-Maj 2022.

Orë mësimi të mbajtura nga stafi akademik				
Muaji	F1	F2	F3	F1+F2+F3
Shkurt	1047	92	213	1323
Mars	1207	49	318	1574
Prill	937	65	225	1227
Maj	1031	71	288	1390
Totali	4222	277	1015	5514

Tabela 3. Orët mësimore të mbajtura nga stafi akademik i rregullt, nga Universiteti dhe i angazhuar për semestrin dimëror të vitit akademik 2022/2023 për periudhën tetor-dhjetor 2021.

Orë mësimi të mbajtura nga stafi akademik – semestri dimëror 22/23				
Muaji	F1	F2	F3	F1+F2+F3
Tetor	806	78	202	1086
Nëntor	1336	110	363	1809
Dhjetor	1183	85	410	1678
Totali	3325	273	975	4573

1.3 Programet e Studimit

Në Fakultetin e Ndërtimtarisë organizohen programe të studimeve të niveleve BSc dhe MSc, ndërsa aktualisht nuk organizohen programe të Doktoratës. Programet e studimeve të klasifikuara të FN-së në Departamente dhe nivele janë sikur:

- Konstruktiv (BSc), dhe (MSc)

- Hidroteknikë (BSc), (MSc)
- Gjeodezi (BSc), (MSc), dhe
- Inxhinieri e Ambientit (BSc)

Programet studimore Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit, në mënyrë të përgjithshme përbëhen nga grupi i lëndëve të përgjithshme, lëndët me karakter formues profesional, lëndët integruese, profesionale, plotësuese dhe punimi i temës së diplomës të nivelit Baçelor e cila është e bazuar në aplikimin e njohurive paraprake dhe në hulumtime paraprake.

E veçantë e aktivitetëve të Fakultetit për këtë vit ishte çështja e riakreditimit të programeve të studimeve. Në këtë vit janë riakredituar programet e studimeve MSc Gjeodezi dhe BSc Inxhinieri e Ambientit, sipas vendimit të Agjencisë për Akreditim të Kosovës përkatësisht KSHC-së këto programe akreditohen për pesë vite të ardhshme përkatësisht deri në vitin 2027.

- Programi i studimeve MSc Gjeodezi – 5 vite (22/23 deri në 26/27)
- Programi i studimeve BSc Inxhinieri e Ambientit – 5 vite (22/23 deri në 26/27)


Raportet e Vetëvlerësimit të Brendshëm për të gjitha programet e studimeve ishin të përgatitura nga FN-ja. Takimet me ekspertët e jashtëm për riakreditimin e programeve u organizuan në një ditë 17 maj 2022. Janë shumë aktivitete paraprake të përgatitjeve të dokumentacionit për riakreditim të programeve për të cilat stafi akademik i mbështetur nga administrata dhe i organizuar nga menaxhmenti dhe departamentet e Gjeodezisë dhe Inxhinierisë së Ambientit i kanë finalizuar me sukses, vlen të theksohet se shkalla e përqindjes së vlerësimit të RVV është 100%.

Aktualisht janë edhe 5 programe tjera të studimeve të cilat janë të riakredituara në vitin 2021 (BSc –Konstruktiv, BSc Hidroteknikë, BSc Gjeodezi, MSc Konstruktiv dhe MSc Hidroteknikë).

Me vendimin e Agresionit të akreditimit nr. 3020/21 të datës 12 gusht 2021, të gjitha programet e studimeve të FN-së riakreditohen sipas kësaj radhitje dhe kohe:

- Programi i studimeve BSc Gjeodezi – 5 vite (21/22 deri në 25/26)
- Programi i studimeve BSc Konstruktiv – 3 vite (21/22 deri në 23/24)
- Programi i studimeve MSc Konstruktiv – 3 vite (21/22 deri në 23/24)
- Programi i studimeve BSc Hidroteknikë – 3 vite (21/22 deri në 23/24)
- Programi i studimeve MSc Hidroteknikë – 3 vite (21/22 deri në 23/24)

Për vitin e ardhshëm 2023 janë zhvilluar të gjitha përgatitjet e nevojshme për akreditimin e programit të studimeve MIRU (Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë). Ky program i studimit MSc do të jetë i mbështetur financiarisht nga SKAT dhe zyra Zvicëranë dhe do të jetë i zhvilluar në gjuhë Anglishte duke insistuar në vlera ndërkombëtare të programeve të Studimeve.



Grafiku 3. Programet e studimeve të FN-së të riakredituara në vitin 2021-2022

Kriteret – standardet e reja të Agjencionit të Akreditimit të Kosovës, përkatësisht Këshillit Shtetërorë të Cilësisë për akreditimin dhe riakreditimin e programeve të studimeve do të jenë sfiduese për programet e organizuara nga FN për periudhën e ardhshme të akreditimeve përkatësisht riakreditimeve. Brenda FN-së organizohen 4 programe BSc dhe 3 programe MSc të studimeve, ndërsa është në procedurë akreditimi i programit të ri për menaxhimin e integruar të resurseve ujore MIRU.

1.4 Mësimdhëniesit, përgjegjësit dhe ligjëratat e dhëna

Organizimi i mësimdhënies përbën shtyllën kryesore të Fakultetit rreth së cilës mbështeten zhvillimet e aktiviteteve tjera shkencore, kërkimore për arritjen e objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të programeve të studimeve.

Mekanizmat e mësimdhënies të cilat zbatohen në IAL-në janë bashkëkohore duke numëruar pedagogët e moshës së re të cilët reflektojnë kreativitet gjatë mësimin, përvojës të madhe profesionale të stafit të pedagogëve të institucionit si dhe grada shkencore të cilat sigurojnë rezultate të kënaqshme në zbrëthimin e fenomeneve shkencore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies të cilat zbatohen janë të shumëllojta, ndër të cilat "mësimdhënia një drejtimore" (nga pedagogu te studenti) duke nxitur studentin në pjesëmarrje direkte aktive në mësim. Këto metodologji të mësimdhënies pedagogun e vejnë në rolin primar jo vetëm të profesorit mirëpo edhe të moderatorit.

Stafi i Pedagogëve përgatitet gjithmonë me metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies duke ju ofruar mundësi e pjesëmarrjes edhe nëpër trajnime permanente të ndryshme të organizuara në nivel të Universitetit <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,78>. Vlenë të përmendet se një numër i konsiderueshëm i stafit akademik të rregullt janë trajnuar nga "Qendra për përsosmëri në mësimdhënie" e Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina". Gjithashtu gjat vitit 2022 janë publikuar shumë oferta për trajnime të mësimdhënësve dhe studentve nga Institucion kombëtare dhe ndërkombëtare <https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,41>.

Në funksion të formës së zgjedhur të mësimdhënies përcaktohet dhe organizimi i mësimdhënies, nëse ai do të jetë ligjëratë, ushtrime numerike, mësim praktik në terren ose edhe ushtrime laboratorike. Personeli akademik është i lirë të zgjedhë metodikën më të përshtatshme për të zhvilluar dhe organizuar lëndën mësimore. Rëndësi të veçantë ju jepet

lëndëve të cilat ushtrojnë vizitat praktike në terrene si dhe ushtrimeve laboratorike duke demonstruar edhe shembuj praktik nga realiteti.

Veçori e Institucionit është monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe mësimdhënësve gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Këtë monitorim e përcjellë vlerësimi i të gjithë mësimdhënësve të angazhuar në programin e studimit të vlerësuar nga studentët. Përmes instrumenteve të vlerësimit të mësimdhënies arrihet cilësia më e lartë e nxënies.

Secila lëndë mësimore ka literaturën e sajë themelore sipas syllabusit dhe literaturën e obliguar dhe të preferuar të cilën Studenti mund ta gjejë ose mësimdhënësi ju siguron paraprakisht.

Kurrikulat e programeve të studimeve si atyre themelore ashtu edhe studimeve master kanë koncept përmbajtësor duke pas për bazë parimet themelore të formimit të programit të studimit nga formimi i grupit të lëndëve të përgjithshme informuese, pastaj grupi i lëndëve teorike shkencore si dhe grupi i lëndëve përmbajtësorë të profesioneve të ngushta nga të cilat dalin edhe kompetencat e veçanta të studentëve pas përfundimit të studimeve.

1.5 Provimet dhe punimet seminarike

Fakulteti i Ndërtimtarisë ka rolin kryesor mësimdhënien dhe mësimdhënien, ku gjatë gjithë kohës ka në qendër të vëmendjes studentin. Përsosja e mësimdhënies arrihet përmes punës kërkimore hulumtuese që realizohet nga personeli akademik i IAL-së. Angazhimi i personelit akademik në fushat e hulumtimeve është prezent jo vetëm në vend, mirëpo edhe jashtë vendit duke dhënë kontribut shkencorë në konferenca shkencore me punime shkencore të publikuara edhe në revistat më prestigjioze në botë të fushës.

Në vitin 2022 janë organizuar provimet e studenteve në afatet e rregullta të janarit, qershorit dhe shtatorit. Duke pas parasysh vendimin e Senatit mbi organizimin e afateve shtesë të provimeve me studentët janë organizuar edhe afatet e prillit dhe nëntorit.

Nga raportet e rezultateve të studentëve të nënshtruara në provime bëhen analiza të sintetizuara për afatet e rregullta të kalueshmërisë si element i cilësisë. Analiza e Raporteve të kalueshmërisë analizohet në nivel të Këshillit të Fakultetit.

Gjatë gjithë kohës së mësimave në semestër në lëndët inxhinierike punohen projekte semestrale të cilat vlerësohen nga mësimdhënësit – asistentët dhe vlerat e arritura nga puna semestrale e studentëve vlerësohet në provimin përfundimtarë. Në shumë nga lëndët mësimore organizohen kolokiume (dy ose tre, në varësi të lëndës dhe metodologjisë së mësimdhënies) gjat semestrit.

E veçantë e vitit 2022 konsiderohet përfshirja e studentëve në punët e angazhimeve të IAL-së me Institucionet e vendit. Vlenë të përmenden përfshirja e studentëve në vlerësimet dhe analizat për objektin e teatrit kombëtar, pastaj muzeut kombëtar, spitalit regional të Ferizajit, ura në Rogovë – Gjakovë, KRU Prishtina, Al Trade etj.

1.6 Diplomat

Numri i të diplomave sipas statistikave të SEMS-it për Fakultetin e Ndërtimtarisë sipas departamenteve, përkatësisht programeve të studimeve për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor të vitit 2022 janë:


Tabela 4: numri i studentëve të diplomuar në nivelin Baçelor të studimeve për vitin 2022

nr	Programi i studimeve – Baçelor	Numri i te diplomarëve
1	Konstruktiv	48
2	Hidroteknikë	26
3	Gjeodezi	37
4	Inxhinieri e Ambientit	22
	Total	133

Tabela 5: numri i studentëve të diplomuar në nivelin Master të studimeve për vitin 2022

nr	Programi i studimeve – Master	Numri i te diplomarëve
1	Konstruktiv	20
2	Hidroteknikë	11
3	Gjeodezi	1
4	Infrastrukturë Rrugore	3
	Total	35

Procedurat e organizimit të diplomave në nivelet BSc dhe MSc janë në përputhje sipas rregulloreve përkatëse të studimeve.



Grafiku 4. Numri i studentëve të diplomuar në nivelet e studimeve BSc dhe MSc për 2022


1.7 Rezultatet e vlerësimit të studentëve

Sipas statistikave të provimeve të organizuara në afatet e rregullta të janarit dhe qershorit 2022, pas analizës dhe diskutimit të vlerave të arritura të vlerësimeve në mbledhjet e këshillit të Fakultetit në vazhdim paraqiten në mënyrë të sintetizuar tabelare dhe grafike.

Tabela 6: Statistikë e rezultateve të arritjes në provime të Studentëve BSc në afatin e provimeve janar 2022

nr	Departamenti	Paraqitja	Abstenua	Kaluan Provimin	%	Nuk kaluan provimi	%
1	Konstruktiv	1272	268	573	57.07	699	42.93
2	Hidroteknikë	318	105	108	50.70	210	49.30
3	Gjeodezi	516	32	187	38.64	329	61.36
4	Inxhinieri e Amb.	281	55	193	85.40	88	14.60
	Totali	2387	460	1061	55.06	1326	44.94

Statistike, rezultatet e arritjes se Studenteve ne Provime
- afati janar 2022



Grafiku 5. Kalueshmëria e Studentëve BSc në afatine provimeve të Janarit 2022

Tabela 7: Statistikë e rezultateve të arrijtes në provime të Studentëve MSc në afatin e provimeve janar 2022

nr	Departamenti	Paraqitja	Abstenua	Kaluan Provimin	%	Nuk kaluan provimi	%
1	Konstruktiv	240	78	134	82.72	106	17.28
2	Hidroteknikë	95	27	62	91.18	33	8.82
3	Gjeodezi	72	7	24	36.92	48	63.08
	Totali	407	112	220	74.58	187	25.42

Statistikë, rezultatet e arrijtes së Studenteve në Provime - afati janar 2022



Grafiku 6. Kalueshmëria e Studentëve MSc në afatine provimeve të Janarit 2022


Në nivel të Fakultetit, kalueshmëria e studentëve në provime, në afatin e rregullt të Janarit 2022 është, 57.65%. Në provime janë paraqitur gjithësej 2794 student, të abstenuar 572 (20.5%).

Në mënyrë analoge sintetizohen pasqyrat e arritshmërive në afatet e rregullta të provimeve në nivel të Fakultetit. Këto vlera diskutohen në nivel të këshillit të Fakultetit.

Tabela 8: Statistikë e rezultateve të arrijtes në provime të Studentëve BSc në afatin e provimeve qershor 2022

nr	Departamenti	Paraqitja	Abstenua	Kaluan Provimin	%	Nuk kaluan provimi	%
1	Konstruktiv	325	79	97	39.43	149	60.57
2	Hidroteknikë	141	43	66	67.35	32	32.65
3	Gjeodezi	512	48	161	34.70	303	65.30
4	Inxhinieri e Amb.	122	22	72	72.00	28	28.00
	Totali	1100	192	396	43.61	512	56.39

Statistikë, rezultatet e arrijtes së Studentëve BSc në provimeve - Afati Qershor 2022



Grafiku 7. Kalueshmëria e Studentëve BSc në afatine provimeve të qershor 2022

Tabela 9: Statistikë e rezultateve të arrijtes në provime të Studentëve MSc në afatin e provimeve janar 2022

nr	Departamenti	Paraqitja	Abstenua	Kaluan Provimin	%	Nuk kaluan provimi	%
1	Konstruktiv	89	60	27	93.10	2	6.90
2	Hidroteknikë	46	18	14	50.00	32	50.00
3	Gjeodezi	23	1	12	54.55	11	45.45
	Totali	158	79	53	67.09	45	32.91



Grafiku 8. Kalueshmëria e Studentëve MSc në afatine provimeve të qershor 2022

Në nivel të Fakultetit, kalueshmëria e studentëve në provime, në afatin e rregullt të qershorit 2022 është, 45.49%. Në provime janë paraqitur gjithësej 1258 student, të abstenuar 79 (6.3%).

KËRKIMET SHKENCORE

Personeli akademik i FN-së jep kontribut të çmuar për shërbime të ndryshme të Fakultetit sipas kërkesave dhe mund të numërohen disa nga këto punë, sikur janë: Raporti i vlerësimit të programeve të studimeve, hartimi i raporteve dhe analizave të ndryshme për nevojat e fakultetit etj. Prandaj, menaxhmetni i FN së bashku me stafin akademik dhe administratën janë të angazhuar jo vetëm në procesin e mësimit, mirëpo edhe në ngritjen e performancave të mësimeve, mësimeve, hulumtimeve shkencore dhe shërbimeve tjera të nevojshme për Institucionin.

2.1 artikujt e botuar shkencor, monografitë dhe botimet tjera shkencore

Si nevojë e madhe e punimeve shkencore të stafit akademik Fakulteti i Ndërtimtarisë të Universitetit të Prishtinës në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës organizojnë konferencën e përbashkët ndërkombëtare të Inxhinierisë së Ndërtimeve në kohën 18 deri 20 maj 2022 në Tiranë <https://www.icce2023.al/>.

Nga tetori i vitit 2022 janë zhvilluar shumë takime në mes të menaxhmenteve të dy IAL-ve me qëllim të krijimit të trupave të domosdoshme të konferencës. Janë themeluar; komiteti këshillëdhënës ndërkombëtar i ICCE2023, komiteti organizativ i ICCE 2023, komiteti shkencor i konferencës si dhe janë përcaktuar Key note speakers.

Konferenca është vazhdim i “2017 International Conference of Civil Engineering – ICCE 2017” që është organizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit-Tiranë dhe Fakulteti i Ndërtimtarisë-Prishtinë dhe është konceptuar që të shndërrohet në një ngjarje të rëndësishme, si shkencore ashtu edhe kulturore.

Për të arritur këtë qëllim është menduar që të ftohen ekspertë/shkencëtarë të spikatur nga Shqipëria, Kosova, Ballkani si dhe vende të tjera nga gjithë Bota, për të dhënë leksione të rëndësishme, të cilat do të pasurojnë sesionet e konferencës duke prezantuar arritjet më të fundit në fusha të ndryshme të inxhinierisë së ndërtimit.

Sesionet e ndryshme të konferencës do të fokusohen në tematikë me interes dhe që kanë një impakt të rëndësishëm në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Këto tematika përfshijnë inxhinierinë e strukturave, inxhinierinë e trafikut dhe të transportit, menaxhimin dhe teknologjinë e ndërtimit, inxhinierinë gjeoteknike, inxhinierinë e tërmeteve, inxhinierinë hidraulike, hidrologjinë, menaxhimin e përmytjeve dhe ujit, inxhinierinë e strukturave

hidraulike dhe detare, inxhinierinë e mjedisit, trajtimin e ujit dhe mbetjeve, eficensen e energjisë dhe energjitë e rinovueshme, inxhinierinë gjeodezike, hartografinë, fotogrametrinë, si dhe trajtimin e ndërtimeve historike dhe monumentale.

Takimi teknik i fundit në mes të dy IAL-ve u organizuara në 22 dhe 23 dhjetor 2022 nga i cili takim dolën qështje organizative të cilat do të zgjedhjen në vazhdueshmëri. U diskutua shtyrja e afateve të dorëzimit të abstrakteve si dhe punimeve shkencore, publikimeve të konferencës, marketingut, mbështetjes finaciare, sesioneve të veçanta, etj.. Në takimet e ardhëshme do të zgjedhën qështje të rëndësishme për mbarëvajtjen e konferencës.

Stafi akademik i FN është i sensibilizuar në maksimum për bartjen e përgjegjësishë për konferencën.

Në bazë të deklarimeve të stafit akademik të FN-së janë disa punime shkencore të punuara brenda vitit 2022 ndër të cilat në tabelën me poshtë janë treguar.

Punime te publikuara		
<i>Autori</i>	<i>Titulli i punimit</i>	<i>Revista</i>
Laura Kusari, Lavdim Osmanaj, Venera Hajdari, Premton Thaqi, Samir Bungu	<i>Trend Analyses of River Dragacina Runoff for Identification of the Water Availability and Accounting for Water Needs</i>	Journal of Ecological Engineering (ISSN 2299-8993) Scopus Web of Science https://doi.org/10.12911/22998993/149721
Laura Kusari, Lavdim Osmanaj, Hana Shehu, Samir Bungu	<i>Flow Rate Determination as a Function of Rainfall for the Ungauged Suhareka River</i>	Journal of Ecological Engineering (ISSN 2299-8993) Scopus Web of Science https://doi.org/10.12911/22998993/146355
Laura Kusari	<i>Turbidity as a Surrogate for the Determination of Total Phosphorus, Using Relationship based on Sub-sampling Techniques</i>	Ecological Engineering and Environmental Engineering Journal (ISSN: 2719-7050) Scopus https://doi.org/10.12912/27197050/150233
Naser Kabashi	High-temperature Behaviour of Concrete with Polypropylene Fibres	5th International Conference on Civil Engineering and Architecture ICCEA 2022. December 16-18, 2022. Hanoi, Vietnam http://www.iccea.org/
Naser Kabashi, Enes Krasniqi, Milot Muhaxheri	FRP COMPOSITE STRENGTHENING OF CONCRETE COLUMNS WITH VARIOUS SHAPES AND LOADING CONDITIONS	Session- MAT-14:
Arton D.Dautaj Cene Krasniqi Ali Sh. Muriqi	Performance Glass Fibre-reinforced Polymer Strengthening Schemes on masonry Infilled RC frames under seismic loading	Journal of Earthquake Engineering 25/2660-2679/2022
Figene Ahmedi L. Ahmedi	Dataset on Water Quality Monitoring from a Wireless Sensor Network in a River in Kosovo	Data in Brief (@) ELSEVIER, vol. 44. 2022 https://doi.org/10.1016/j.dib.2022.108486 https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S2352340922006801

2.2 Raportet e projekteve shkencore

Projektet Erasmus+ të FN-së

Mbështetur në Strategjinë e miratuar të Fakultetit të Ndërtimtarisë për periudhën 2021-2023, vizioni i njësisë akademike ndër të tjera është i bazuar në Globalizimin dhe Ndërkombëtarizimin “Ndërkombëtarizimi i Fakultetit përmes pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, bashkëpunimi i ndërsjellë me institucionet relevante në projektet hulumtuese, publikimet shkencore në revista kredibile, kongrese dhe konferenca ndërkombëtare”. Në përmbushje të vizionit të Fakultetit dhe të Strategjisë së zhvillimit menaxhmenti, stafi akademik i ndihmuar me administratën organizojnë takime, vizita dhe ngjarje të ndryshme në nivele të vendit dhe ndërkombëtar.

Gjatë këtij viti IAL-ja ka në vazhdueshmëri lidhur me projektet ndërkombëtare të fituara Erasmus + sikur që janë:

- Erasmus + BKSTONE (Key action 2) me konsorcium,
- Erasmus + GEOBIZ (Key action 2) me konsorcium,
- Erasmus + Credit Mobility (Key action1) me Trento University,
- Erasmus + Mobility for learners and staff, BOKU University Wien.

Si rezultat i projekteve ndërkombëtare të FN-së janë organizuar punëtori brenda institucionit tonë, jashtë vendit, vizita me karakter pune, trajnime të stafit administrativ si dhe mobilitete të studentëve dhe të stafit akademik. Disa nga aktivitetet të tilla tregohen sikur në vazhdim:

- BKSTONE; “*Higher Education-Enterprise Platform for Fostering Modernization and Sustainable Growth in Natural Stone Industry in Western Balkans 610483-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP*,”. Vlera e përfitimit të FN-së nga projekti është 35.958,41€.
 - a. Punëtori: Në kuadër të zhvillimit të Projektit sipas planit të veprimit, 24 deri 25 shkurt 2022, Podgorica, Monte Negro 23-24.02.2022.
 - b. Aktivitet: Në kuadër të zhvillimit të dhe shpërndarjes së Projektit sipas planit të veprimit, prill 2022, organizohet ligjeratë në Fakultetin e Ndërtimtarisë.
 - c. Punëtori: “Mining and Quarrying, Manufacturing” e organizuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë në Prishtinë me 18 dhe 19 maj 2022 e udhëhequr nga bartësit e projektit IES, Amador Ordenez dhe UnCoruna, Santiago Lopez.
 - d. Punëtori: “Mining and Quarrying, Manufacturing” e organizuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë në Prishtinë me 29 dhe 30 gusht 2022 e udhëhequr nga bartësit e projektit IES, Amador Ordenez me pjesëmarrës nga konzorciumi prej 13 vendeve.
 - e. Aktivitet: Në kuadër të zhvillimit të dhe shpërndarjes së Projektit sipas planit të veprimit, 26 deri 30 shtator 2022, organizohet vizitë në Verona Itali.
 - f. Punëtori: Në kuadër të përmbylljes së projektit organizohet punëtori sipas planit të veprimit në të cilin rast përveç tjerash janë edhe botimet e materialeve në dy vëllime, 04 deri 05 nëntor 2022, e organizuar në Tiranë.

- GEOBIZ, Business driven problem-based learning for academic excellence in geoinformatics, Funded by Erasmus+ Programme of the European Union. Konzorciumi i përbërë nga 18 Universitete të vendeve të ndryshme. Nga ky projekt Fakulteti i Ndërtimtarisë përfiton përveç tjerash edhe pajisjet – instrumentet Gjeodezike me qëllim të avancimit të mësimdhënies dhe rritjes së kapaciteteve të laboratorëve dhe zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve nga Departamenti i Gjeodezisë përkatësisht programeve të studimeve BSc dhe MSc Gjeodezi. Vlera e përfitimit të FN-së nga projekti është 29.690,00€. <https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,90>
 - a. Punëtori: Në kuadër të zhvillimit të dhe shpërndarjes së Projektit sipas planit të veprimit, 28 shkurt 2022, organizuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë në Prishtinë me temën “Sfidat dhe metodat inovative të bashkëpunimit në arsimin e lartë akademi-biznes për nevojat e tregut të punës”.
 - b. Punëtori: Në kuadër të përmbylljes së projektit organizohet punëtori sipas planit të veprimit, 09 deri 11 nëntor 2022, e organizuar në Tiranë
- Credit Mobility, Trento University, Key action 1, Mobility for learners and staff – Higher Education Student and Staff Mobility.
 - a. Mobilitete të studentëve, janë tre student nga programi i studimit BSc Inxhinieri e Ambientit të cilët janë për një semestër në Univesitetin Trento. Studenti i katërt i selektuar fillon semestrin në vitin 2023 në muajin shkurt.
 - b. Trajnime të dy anëtarëve të stafit administrativ të Fakultetit në Universitetin Trento (13 deri 17 qershor 2022).
 - c. Katër mësimdhënës (2 profesor dhe dy asistent) nga 5 deri 9 dhjetor kanë qenë profesor vizitor në Universitetin e Trentos.
- Erasmus + Mobility for learners and staff, BOKU University Wien, sipas agjendës do të organizohen mobilitete të stafit akademik brenda viteve 2023 dhe 2024.

Si pjesë e Erasmus + Staff mobility for Training, është ftuar Dekani i Fakultetit për trajnim një javor (2deri7 maj) lidhur me organizimin dhe ndërlidhjen ndërkombëtare të Institucioneve.

2.3 Pjesëmarrjet në konferenca dhe punimet e paraqitura

Stafi akademik i Fakultetit u ftua në qershor të vitit 2022 ne Poznan University Life Science, Poland për pjesëmarrje në “3rd International Conference on Ecological and Environmental Engineering in Poznań” për stafin e FN-së. Me të cilin rast ishte delegacion i përbërë prej 6 mësimdhënësve të cilët morën pjesë në konferencë edhe me punime shkencore <https://coee.urk.edu.pl/>. Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit të FN, UP dhe PULS, Poloni dhe propozimit të partnerëve për konferencën e ardhëshme të 4-të të ICEEE e cila mbahet në Portugali në vitin 2024 Universiteti i Prishtinës përkatësisht Fakulteti i Ndërtimtarisë do të jetë anëtar i organizimit të konferencës dhe në të ardhmen planifikohet të jemi Organizator të kësaj konference.

Në 19 dhjetor 2022, Akademia e Shkencave të Shqipërisë organizon punëtori lidhur me Eurokodet, standardet për Strukturat për të cilin aktivitet Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

në Tiranë i bënë ftesë Fakultetit të Ndërtimitarisë së UP-së. Në këtë punëtori Fakulteti përfaqësohet nga dy mësime të lidhura me temën.

Në 10 Nëntor 2022, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit të UPT, organizon konferencë me titull “Aplikimi i teknologjive të pastra për një mjedis të qëndrueshëm (ATPMQ)” në të cilin rast Fakulteti ishte i ftuar në rolin e bashkëkoordinatorit të konferencës, ndërsa morën pjesë edhe disa nga stafi akademik i FN-së me punime shkencore. Në kuadër të konferencës së parë kombëtare aplikimi i teknologjive të pastra për një mjedis të qëndrueshëm (ATPMQ), të organizuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit, ka zhvilluar nga data 10-11 Nëntor 2022.

Konferencën e hapen Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës Prof. Dr. Andrea Maliqari, Deknani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit Prof. Asoc. Dr. Neritan Shkodrani, Prof. ass. Dr. Florim Grajcevi Dekani i Fakultetit të Ndërtimitarisë, Universiteti i Prishtinës dhe Prof. Asoc. Dr. Olti Marko, Shef i Departamentit. Konferenca ka karakter shkencor me 42 punime të fushave të inxhinierisë së ambientit dhe fushave inxhinierike të lidhura me ambientin. Një numër i punimeve të konferencës ishte nga pjesëmarrësit nga Kosova përkatësisht nga Fakulteti i Ndërtimitarisë të Universitetit të Prishtinës.

Pjesëmarrje në Konferencë ndërkombëtare me perfaqësim të Fakultetit të Ndërtimitarisë dhe UP. ISEC, The Fourth European and Mediterranean Structural Engineering and Construction Conference, EURO MED SEC 4. State-of-the art Materials and Techniques in Structural Engineering and Constructions. Leipzig, Germany, June 20-25, 2022. Website: https://www.isec-society.org/EURO_MED_SEC_04/. Session V-C: Building Construction II Room G 332 (Geutebrück-Building) Moderator: NASER KABASHI Co-Moderator: AYSHA HAROON Session III-B: Analysis II Room G 327 (Geutebrück-Building) Moderator: EDWARD MINCHIN Co-Moderator: NASER KABASHI

AKTIVITETE TË NDRYSHME TË FAKULTETIT TË NDËRTIMTARISË

Inventarizimi i sallave të mësimi me pajisje të konkretizimit, “Smart board” TV, tabela mësimi etj. është karakterizuese për këtë periudhë raporti, secila klasë mësimi posedon video projektorin ndërsa 6 klasë mësimi janë pajisur me TV smart board.

Si rezultat i marrëveshjes në mes të SKAT dhe UP, përkatësisht FN-së, është rinovuar dhe pajisur Laboratori i Hidroteknikës dhe Inxhinierisë së ambientit, ndërsa janë zhvilluar procedurat e tenderimit për pajisje të laboratorit të Strukturave dhe është nënshkruar kontrata e cila do të përmbushet në vitin 2023.

Gjatë semestrit veror janë realizuar shumë vizita studimore me studentët nga mësime të ndryshme në objekte dhe lokacione brenda Kosovës dhe kryesisht në Shqipëri.

Fakulteti ndanë mirënjohje për studentët e dalluar për çdo vit akademik. Edhe këtë vit janë shpallur studentët më të mirë sipas kriterëve: nota mesatare më e lartë (mbi notën 8) dhe nga një student nga secili program i studimit. Për këta studentë, shënimet e tyre janë publikuar në faqen elektronike të Fakultetit.

Në mënyrë të rregullt, menaxhmenti i FN-së organizon takime me studentët si dhe me këshillin e studentëve të FN-së duke identifikuar prioritetet, nevojat si dhe kërkesat e tyre.

Administrata e Fakultetit është angazhuar në maksimum për punët e përditshme si dhe në raste edhe për punët e shtuara në varësi të nevojave të fakultetit sikur ishin organizimet e

shumta që u bënë brenda vitit 2022 (ligjëratat e Hapura, manifestimi i ditës botërore të ujit, takime sociale dhe shoqërore në Tiranë dhe Prishtinë).

3.1 Staf i akademik i Fakultetit të Ndërtimitarisë

Stafi Akademik i rregullt, është aktiv në avancime me grada shkencore dhe tituj akademik. Njësia jonë akademike hulumton edhe tregun e punës për krijimin e mundësive të reja me kuadro profesionale dhe aktualisht mendohet edhe për krijimin e programeve të reja të studimeve.

Duke pas parasysh lëvizjet e stafit akademik, avancimet, pensionimet, mundësitë e projekteve të reja për programe të studimeve Fakulteti është i detyruar të riorganizohet në vazhdimësi në mënyrë që të arrihet cilësia sa më e lartë e studimeve dhe njëkohësisht të mendohet edhe në projektet e ardhshme.

Nga janari deri në qershor të vitit 2022, numri i stafit akademik me kontratë të rregullt 36, nga të cilët 18 janë mësimitdhënës ndërsa 18 janë asistent.

Janë dy profesor, mësimitdhënës të rregullt të pensionuar në qershor-korrik të këtij viti, dhe nga korriku deri në vazhdim stafi akademik i rregullt i Fakultetit është 34 mësimitdhënës, nga të cilët 16 mësimitdhënës janë profesor dhe 18 janë asistent. Listës së mësimitdhënësve i shtohen edhe dy profesor vizitor: një nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe një nga Universiteti Teknik i Vjenës të angazhuar për vitin akademik 2022/2023.

Lidhur me avancimin e stafit akademik të Fakultetit, në nivel të Universitetit është zhvilluar dhe përfunduar konkursi i rregullt me të cilin janë avancuar: një mësimitdhënës nga profesor i asocuar në profesor, tre mësimitdhënës nga Profesor asistent në Profesor të asocuar dhe një asistent është avancuar në profesor asistent. Ky konkurs ka përmbajtje edhe ripërtëritjen e stafit akademik me rizgjedhje në pozita të njëjta për stafin akademik.

Stafi akademik i angazhuar brenda UP-së (F2) nga njësitë tjera akademike për semestrin verorë 2021/2022 janë gjithsej 14, ndërsa për semestrin dimëror të vitit akademik 2022/2023 janë gjithsej 15, nga të cilët 10 profesor dhe 5 asistent.

Stafi akademik i angazhuar me kontratë (F3), sipas konkursit, për semestrin verorë të vitit akademik 2021/2022 janë 17 mësimitdhënës sikurse edhe për semestrin dimëror të vitit akademik 2022/2023 janë gjithsej 17 mësimitdhënës. Për angazhimin e stafit akademik me kontratë (F3) është organizuar konkursi në nivel të njësisë akademike dhe miratuar nga Senati i Universitetit të Prishtinës.



Grafiku 9. Staf i akademik i FN (sipas angazhimeve F1, F2 dhe F3) për vitin 2022

Konkursi “Për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjëratat dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të UP “Hasan Prishtina””, për vitin akademik 2022/23 nga

Fakulteti i Ndërtimtarisë ka zgjedhur mësimdhënës për 12 pozita (4 mësimdhënës, 1 lektore dhe 7 asistent).

3.2 Aktivitetet sociale të FN-së

Brenda vitit kalendarik janë zhvilluar aktivitete akademike të shumta brenda Institucionit me qëllime të rritjes së bashkëpunimeve kolegjalë, rritjes së cilësisë së mësimdhënies si dhe afërsia me studentët. Aktivitetet janë të natyrave nga më të ndryshmet dhe janë zhvilluar gjatë gjithë vitit.

Nga 27 prill deri në 13 maj, janë organizuar “Ditët e Hapura” nga Fakulteti i Ndërtimtarisë me stafin akademik i mbështetur nga stafi administrativ, duke organizuar vizita në shkollat e mesme të Kosovës me qëllim sensibilizimin e tyre rreth IAL-së, programeve të studimeve brenda njësisë tonë akademike si dhe veprimtarive shkencore e hulumtuese. Për organizimin e “ditëve të hapura”, janë formuar 25 grupe punuese të përbëra nga stafi akademik të cilët kanë vizituar 49 shkolla të mesme në 25 qytete dhe lokacione të Kosovës. Gjatë vizitës janë shpërndarë broshura të Fakultetit me përmbajtje të njoftimeve të sintetizuara për fakultetin. Konsiderohet se kjo fushatë e organizuar nga menaxhmenti, stafi akademik i fakultetit, mbështetur nga administrata është ngjarje sociale e karakterizuar me një unifikim të madh dhe se ka sensibilizuar rininë e vendit si dhe ka siguruar një prurje të studentëve të rinjë.

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit të IAL-së me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës është organizuar takim pune i përbashkët i dy Institucioneve në Tiranë nga data 27 deri 30 maj. Takimet janë realizuar në Tiranë, në ambientet e Fakultetit dhe ishin me produktivitet që bashkëpunimet të vazhdonin në shumë fusha. Gjatë vizitës janë organizuar edhe takime pune si dhe mbrëmje sociale të stafit akademik dhe administrativ të Fakultetit.

Brenda vitit janë organizuar shumë takime të brendshme të menaxhmentit me grupe të ndryshme punuese të stafit akademik duke shtjelluar tema dhe aktualitete të rëndësishme për Institucionin si dhe takime me administratën e Fakultetit.

Administrata e Fakultetit organizoj takime përshëndetëse për rastin e pensionimit të punonjësit zyrtar për financa.

Me qëllim përmbylljen e vitit kalendarik menaxhmenti, stafi akademik së bashku me administratën me vetëfinancim organizojnë mbrëmjen festive duke kontribuar në socializmin dhe mbështetjen, përkrahjen e njëri tjetrit.

3.3 Aktivitetet akademike në bashkëpunim me tregun e punës të FN-së

Bordi Industrial i Fakultetit brenda vitit ka organizuar shumë takime me karakter pune. Gjatë gjithë punës një vjeçare Bordi i Fakultetit ka mbështetur njësinë tonë dhe studentët duke ju ofruar punë praktike në ndërmarrjet vendore si dhe në organizimin e ligjëratave të hapura duke siguruar edhe përkrahje financiare.

Fakulteti i Ndërtimtarisë me traditën e vet institucionale, duke promovuar punën hulumtuese, praktikat e rasteve studimore, projektet e veçanta të niveleve kombëtare dhe ndërkombëtare organizon ligjëratat të hapura me tema të ndryshme nga fushat inxhinierike sikur janë

Strukturat, Hidroteknika, Gjeodezia, Inxhineria e Ambientit, të cilat lidhen me analiza shkencore, studime të projekteve, raste studimore, çështje të efekteve ambientale dhe sociale.

Qëllimi i Organizimit të ligjëratave të Hapura brenda FN-së për studentët, stafin akademik dhe tregun e punës është sensibilizimi me të arriturat shkencore, vështirësitë, sfidat dhe praktikat për realizimin e studimeve, projekteve dhe ndërtimeve për raste konkrete, zbërthimi i problemeve shkencore dhe të tjera.

Janë një numër i konsideruar i organizimit dhe mbajtjes së ligjëratave të hapura në Fakultetin tonë me prezantues eminent vendor dhe nga Institucionet e jashtme Evropiane. Sipas agjendës së shpallur në kohë të mbajtjes së ligjëratave të hapura brenda vitit numërohen:

- 28 shkurt 2022, prezantuesi Nehat Koqinaj, përfaqësues dhe zyrtar i lartë i Agjencisë së menaxhimit të emergjencave në Kosovë, me titullin e temës “Arkitektura e mbrojtjes dhe sigurisë e republikës së Kosovës”
- 12 maj 2022, prezantuesi Prof.Dr. Jose C. Matos, Universidad de Minho, Portugali, me titullin e temës “From quality control to decision-making on the management of bridges and structures: What’s next?”
- 4 maj 2022, prezantuesit Prof.Florian Kretschmer dhe Thomas Ertl, Universiti BOKU, Vjenë. Austri me temën “Ripërdorimi i ujërave të zeza për ujitje, prodhim i energjisë dhe në Bujqësi” dhe “Menaxhimi i Përmbytjeve Urbane”.
- 06 qershor 2022, prezantuesi AI Trade, me përfaqësim nga Arkitektët dhe Inxhinierët e kompanisë prezantojnë sfidat e projektimit, ndërtimit të objekteve rezidenciale, praktikat e zhvillimit të projekteve dhe ndërtimeve.
- 22 qershor 2022, prezantuesi Dr. Alexander Bittner, Head of Division Environmental Communication at the German Federal Environmental Foundation (Deutsche Bundesstiftung Umwelt – DBU), me temën “Fellowships for graduates from Central- and Eastern Europe (CEE) for advanced qualification”.
- 27 tetor 2022, prezantuesi Dr.Sc. Markel Baballeku, zv.Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës me temën “Building Performance, Damage Caused by the Earthquake of November 26, 2019 in Albania”.
- 16 dhe 17 Nëntor 2022, Prezantues Prof.Dr. Fabio Masi, Environmental science IRIDA, Water and management environmentally sustainable water resources, me titull “Water and Management Environmentally Sustainable Water”.
- 24 nëntor 2022, prezantues Prof.Dr. Karel Pavelka, vice Dean, for International Relations/Faculty of Civil Engineering, Czech Technical University in Prague, me temën “Modern Technologies in Geomatics”.
- 09 dhjetor 2022, prezantues Prof.ass.Dr. Teresa Liberto, Chemical Engineer, Faculty of Civil Engineering, Research area of Materials Science and technology, Technical University of Vien, me temën “Rheology and Interaction of Cementitious Slurries”.
- 16 dhjetor 2022, prezantues Samir Mejzini, Structural Engineer, Senior Assurance Manager MACE, me temën “Health and Safety, Study Case, Buildings in UK, London”

Të gjitha ligjëratat e Hapura të organizuara ishin të përcjellura nga stafi akademik dhe studentët e Fakultetit pa përjashtuar edhe audiencën e jashtme që ishin prezent në shumë prej ligjëratave.

Në Fakultetin e Ndërtimtarisë, Departamenti i gjeodezisë, përmes programit FULBRIGHT është duke qëndruar për një periudhë 9 mujore, Dustin Sanchez nga Universiteti shtetor i Texas-it. Dustin do të realizoj hulumtimet e tij në tematikën e kadastrës së vreshtave dhe zhvillimit periodik të aktivitetit vreshtar në Kosovë. Fakulteti i Ndërtimtarisë, stafi akademik dhe administrativ kanë organizuar akomodimin e Dustin në arritje të hulumtimeve shkencore në mënyrë të pa kufizuar.

3.4 *Bashkëpunimet ndërkombëtare të FN-së, vizitat e organizuara brenda dhe jashtë vendit.*

Stafi akademik i Fakultetit përkatësisht Departamentet e Hidroteknikës dhe Inxhinierisë së Ambientit në bashkëpunim me Menaxhmentin dhe administratën e Fakultetit gjatë gjithë vitit kanë organizuar aktivitete që i takojnë programit të studimeve MIRU (IWRM). Aktivitetet e rëndësishme për progresin e programit të studimit MSc, në Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore -MIRU janë të matshme dhe konkrete, nga të cilat janë arritur:

- Marrëveshje bashkëpunimi në mes të Universitetit të Prishtinës, FN dhe Technology Arts Sciences TH Koln, Gjermani, e lidhur në qershor të vitit 2022. Sipas marrëveshjes në mes të dy Institucioneve përveq bashkëpunimeve tjera direkte lidhur për programin e studimeve MIRU do të angazhohen mësimdhënës nga TAS TH Koln në Fakultetin e Ndërtimtarisë.
- Nga bartësit e programit të studimeve MIRU, të Fakultetit me ndihmën e menaxhmentit dhe stafit akademik dhe administratës janë organizuar punëtori lidhur me prezantimin e programit të studimeve.
- Sipas rregulloreve të brendshme të Universitetit të Prishtinës, programi i studimeve MSc MIRU ka kaluar në komisionin për cilësi dhe komisionin për studime si trupa mbështetëse të Senatit të UP-së dhe është miratuar nga Senati me vendim të veçantë që programi i studimeve MIRU të vazhdoj procedurat e mëtejme lidhur me akreditimin.
- Nga mbledhja e datës 19 dhe 20 dhjetor e KSHC -së të Agjencisë për Akreditimit të Kosovës është miratuar programi i studimeve MIRU për dorëzimin e dosjes dhe RVV-së për akreditim.

Programi i studimeve MSc për MIRU sipas agjendës pritet të akreditohet në vitin 2023 ku edhe do të fillohet me punë nga 1 tetori i 2023.

Lidhur me programin e studimeve MIRU, sipas marrëveshjes me SKAT të nënshkruar në vitin 2021, janë përmbushur një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve. Janë investuar 150.000,00 € me procedura të prokurimit të realizuara nga SKAT duke rinovuar sallën e laboratorit, sallën e kompjuterëve, furnizimi me pajisje laboratorike, 10 kompjuter, 2 smart board, softare profesionale dhe të tjera. Laboratori i rindërtuar dhe i pajisur është përfunduar me 14 tetor 2022.

Si rezultat i arritjes së marrëveshjes në mes të UP, FN dhe TASTH Koln, Gjermani, është organizuar vizitë pune një javore (shtator 2022) në Universitetin e Kolnit, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit edhe në fushat e kërkimeve shkencore, shkëmbimit të kuadrove si dhe të studentëve.

Në mars të vitit 2022, menaxhmenti i Fakultetit viziton TU Wien Faculty of Civil Engineering, Research Unit of Building materials and material technology në Vjenë, Austri. Takimi kishte karakter pune dhe u arrit marrëveshja që të organizohet punëtori në UP, FN sipas agjendës 04 dhe 05 maj 2022 me tematikat e materialeve të betonit për strukturat.

Si rezultat i kësaj marrëveshje, sipas propozimeve të departamenteve dhe miratimit të këshillit të Fakultetit kërkohet nga Senati i UP-së marrjen e vendimit për profesor vizitor nga TU Wien për Prof.Dr. Teresa Liberto. Sipas vendimit të Senatit, Prof.Dr. Teresa Liberto ka organizuar ligjëratat gjatë semestrit dimëror në programin e studimeve MSc Konstruktiv.

Në po të njëjtën kohë, menaxhmenti viziton Czech Technical University, Faculty of Civil Engineering, në Pragë, Çeki. Nga takimet e zhvilluara është arritur marrëveshje bashkëpunimi në mes të dy Institucioneve UP, FN dhe CTU, FCE e nënshkruar në qershor të vitit 2022.

Si rezultat i marrëveshjes është zhvilluar vizitë nga stafi menaxherial i CTU, FCE në Fakultetin e Ndërtimitarisë, zëvendës Dekani, Prof.Dr. Karel Pavelka. Vizita u organizua në Nëntor të vitit 2022 dhe nga takimet e organizuara me stafin akademik të fakultetit u dakortësuan lidhur me bashkëpunime konkrete për të ardhmen.

Nga ata 11 deri me 15 Korrik 2022 me ftes te Universitetit të Hamburgut stafi akademik – shefi I departamentit të Inxhinierisë së Ambientit merr pjesë ne Konferencën e Organizuar lidhur me “Monitorimin e Ujerave Nëntokësore” në të cilin rast është prezantuar gjendja e Ujerave nëntokësore në Kosove. Në takimet me stafin akademik vendas të IAL-së, Prof.Dr. Mathias Ernst, përgjegjës për Menaxhimin e Ujerave dhe Furnizimit me Ujë është diskutuar lidhur me bashkëpunimin ne mes dy Fakulteteve tona.

Në kalendar të shënimeve Botërore, 22 marsi konsiderohet “**Dita Botërore e Ujit**”, stafi akademik së bashku me departamentet e Hidroteknikës dhe Inxhinierisë së Ambientit organizojnë punëtori njëditore me karakter ndërkombëtar. Pjesë e punëtorisë ishte edhe Poznan University of Life Sciences, Faculty of Environmental and Mechanical Engineering Poland, Dekane e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Ambientit Prof.Dr. Klaudia Borowiek.

Nga ky rast, u nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet UP, FN dhe Poznan University of Life Sciences, Poland. Kjo marrëveshje bashkëpunimi ndihmohet me përfaqësues Student të UP, FN tek PULS-FEME, Poland që është në fazën e përfundimit të studimeve të Doktoratës Arlinda Caka.

Në qëllimin e përmbushjes së marrëveshjes së bashkëpunimit, FN-ja fton për vizitë Universitetin Poznan të Polonisë. Vizita organizohet nga 31 tetor deri në 04 nëntor 2022 në Institucionin tonë. Këto takime direkte mundësuan thellimin e bashkëpunimeve edhe në fusha tjera direkte, sikur (citat nga marrëveshjet e arritura):

1. *The University of Prishtina “Hasan Prishtina” Summer School will be promoted to Poznan University of Life Sciences’ students, and the University of Prishtina aims to welcome as many Polish students as possible. The University of Prishtina will share*

- all pertinent information on the summer school program, dormitories, and life in Prishtina to all interested students from the Poznan University of Life Sciences.*
- 2. The Faculty of Civil Engineering of the University of Prishtina "Hasan Prishtina" and the Poznan University of Life Sciences aim to apply for the KA171 and/or other mobility opportunities to enable the creation of an Erasmus+ exchange program between the two Universities. This program will include reciprocated staff mobility, such that academic staff from Prishtina can go to Poznan and vice versa, and especially staff from the Geodesy department in FCE is requested. The student mobility as of now is planned to be one sided, such that the students from the University of Prishtina can study for one semester in Poznan University of Life Sciences.*
 - 3. During this visit, the International Conference of Civil Engineering 2023 (ICCE) was presented, and the Poznan delegation was invited to participate in the conference which will be held in Tirana and is a joint effort of the University of Prishtina and the Polytechnic University of Tirana. The Faculty of Civil Engineering of the University of Prishtina extended an invitation to the Poznan University of Life Sciences, not only to participate in the conference, but also to provide the Keynote Speaker and scientific organization members for the conference.*
 - 4. Joint Webinars – both universities agreed to hold joint webinars on different topics such as for Water Day, GIS Day and Drone Day. Both universities will cooperate in holding lectures for pertinent topics for these days, and they will coordinate to have lecturers from both universities on each topic. In addition to webinars, the universities are open to cooperate in organizing additional events together in the course of celebrating the aforementioned holidays.*
 - 5. The University of Prishtina is currently working towards accrediting a new master program on "Integrated Water Resource Management" (IWRM-K), supported by the SDC and SKAT ltd. During this visit, the Poznan University of Life Sciences expressed interest on behalf of Polish students to join this new Master Program which will be offered in English. Additionally, the Poznan University has expressed their readiness to aid the University of Prishtina during the accreditation process for this new program.*
 - 6. The Poznan University will aid and support the University of Prishtina, specifically the Faculty of Civil Engineering to be part of network and to join to 13 other Institutions at the 2024 Conference in Portugal. It is expected that when this Conference is held in 2026 in Poland, the FCE of the University of Prishtina will be the 14th participant.*

The two Universities have agreed to cooperate and aid each other in competing for the CEEPUS Mobility Grant. CEEPUS (Central European Exchange Program for University Studies) is an exchange academic programme in the fields of education and research which involves 15 Central-European countries, that offers both teachers and students opportunities to spend a study or teaching period abroad at the partner universities. The main activity of CEEPUS is university networks (created minimum 3 universities from 3 different countries) operating joint programs. CEEPUS offers mobility grants for students and teachers in this framework. It is a unique opportunity to share knowledge and experiences among countries with a common cultural heritage and a strong background of academic cooperation. The

University of Prishtina and Poznan University have agreed to cooperate and jointly find another university to apply for CEEPUS.

Janë realizuar aplikime ne projekte nderkombetare nga Fakulteti i Ndërtimtarisë duke u angazhuar stafi akademik ne maksimum per te fituar projekte duke qqene pjese e tyre stafi akademik, studentet si dhe tregu u punës me partnere. Projektet ku FN-ja ka aplikuar:

1. University of Prishtina, Faculty of Civil engineering, Department of Geomatics, Geoinformation, Space and earth Observation. Project proposal: “ Digital approach for assessing market knowledge gap and geographic context for development of climate change resilience in the Kosovo wine market“ Aplikimi në dhjetor 2022, në bashkëpunim me GIZ.
2. DOD Defensive Health Program, Congressionally Directed Medical Research Programs. (CDMRP) Toxic Exposures Research Program (TERP) Translational Research Award. Subject: Letter of collaboration for the project titled "Geographic modeling chronic exposure to lignite coal plants for in vivo and in vitro inhalation toxicological assessment of US Service Members based in Kosovo"; Dr. T. Edwin Chow, Principal Investigator.

If the proposal "Geographic modeling chronic exposure to lignite coal plants for in vivo and in vitro inhalation toxicological assessment of US Service Members based in Kosovo" submitted by Dr. T. Edwin Chow is selected for funding, it is my intent to collaborate and/or commit resources as detailed in the Project Narrative or the Scope of Work (SOW) section of the proposal. The Indirect Cost Rate at the University of Prishtina is 50.5%.

3. Me date 15 gusht 2022 është shpallur thirrja nga SKAT për projekte Hulamtuese shkencore e cili është mbyllur me date 20 Shtator 2022, ku nga Fakulteti i Ndërtimtarisë ka aplikuar me dy projekte “Hulamtimi i Ujerave Nëntokësor në qytetin e Lipjanit dhe caktimi i zonave mbrojtëse” si dhe projekti “Ndryshimet e përdorimit të Tokës ne Bilancin Ujor për Pellgun Lepenc” me 20 dhjetor 2022 jemi njoftuar nga SKAT se potencialisht jemi fitues të projektit “Hulamtimi i Ujerave Nëntokësor në qytetin e Lipjanit dhe caktimi i zonave mbrojtëse” Në 13 janar 2023 është dorëzuar pjesa e dytë e propozimit ku pritet që nga muaji shkurt 2023 të fillojë projekti.

Fokusi kryesor i projektit është Realizimi i të paktën dy punimeve te publikuar ne Revista Prestigjioze si dhe pjesëmarrja ne një Konferencë, po ashtu me pajisjet qe do jeni prone e Fakultetit ne vitet ne vijim te vazhdohet me zonat tjera për punët e njëjta

3.5 Bashkëpunimet në nivel vendi të FN-së, vizitat, punëtoritë, aktivitete akademike te organizuara.

Në rastin e ditës botërore të Tokës, Fakulteti së bashku me FIEK dhe FIM organizuan aktivitete rreth objektit te fakulteteve Teknike, mbjellja e fidanëve, pastrimi i hapësirave rreth objektit, grumbullimi i mbeturinave, takime me studentet, administratën dhe stafin akademik.

Si nevojë e zhvillimit të IAL-së, me shumë institucione të vendit u arritën marrëveshje të cilat kishin qëllim krijimin e mundësive të zhvillimit të praktikave për studentët. Në 25 mars 2022 u nënshkrua marrëveshja në mes të UP, FN dhe Hidroregjioni Prizren. Në 2 mars 2022 u nënshkrua marrëveshja në mes të UP, FN dhe Hidroregjioni Mitrovicë. Në 21 prill 2022 u nënshkrua marrëveshja në mes të UP, FN dhe Ministrisë së Planifikimit Urban dhe

Infrastrukturës. Në shtator 2022 u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit në mes të UP, FN dhe SHUKOS. Në dhjetor 2022 u nënshkrua aneks memorandumit në mes të FN dhe KRU Prishtina. Gjatë vitit u nënshkruan edhe marrëveshje dhe aneks marrëveshje me Komunën e Gjakovës për projektin e urës së Rogovës, marrëveshja në mes të UP, FN dhe Ministrisë së shëndetësisë për spitalin regional të Ferizajt. Aneks marrëveshjet për realizimin e vlerësimeve të gjendjes ekzistuese të teatrit kombëtar të Kosovës, muzeut kombëtar të Kosovës, Marrëveshja në mes të Komunës së Prishtinës dhe UP, FN, etj.

Nga marrëveshjet e realizuara janë më shumë se 20 studentë që kanë zhvilluar praktika profesionale në shumë raste me mbështetje financiare. Në disa nga marrëveshjet Fakulteti me grupe të formuara punuese në përbërje staf akademik dhe student janë angazhuar për verifikim të kapaciteteve të objekteve ekzistuese, vlerësimin e tyre nga rreziku i mundur për shfrytëzim të objekteve etj.

Janë zhvilluar shumë vizita të objekteve ekzistuese dhe që janë në ndërtim, impianteve ekzistuese të ujit të pijes, pastrimit të ujërave fabrikave ndërtimore etj. në Kosovë dhe në Shqipëri.

Gjatë vitit 2022 u organizuan takime pune të shumta në mes të FN, UP dhe FIN, UPT. Në maj 2022 ishte takimi në Tiranë i organizuar ndërmjet dy IAL-ve, pastaj në 20 dhe 21 qershor Takimi i organizuar në mes të UP dhe UPT, përkatësisht ndërmjet FN dhe FIN me qëllim të thellimit të bashkëpunimit. Në takimin e qershorit u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit në mes të UP dhe UPT, ndër të tjera u publikua ideja e organizimit të Konferencës së përbashkët Tiranë-Prishtinë me karakter ndërkombëtar.

Janë shumë lëndë gjygjësore për të cilat është kërkuar nga Fakulteti të krijohen ekspertiza nga mësimdhënësit.

3.6 Aspekte financiare në FN:

- Realizimi i kontratës së renovimit të objektit të Fakultetit, niveli 400. Buxheti është i përbashkët nga tri fakultetet teknike (FN, FIEK dhe FIM) në vlerë rreth 210,000.00€. Kontrata e nënshkruar nga operatori është në vlerë prej 175,990.90€. Projekti është ë i finalizuar në shkurt të vitit 2022.
- Është realizuar projekti i “Kulmit të Objektit të Fakultetit” për vitin 2022. Janë zhvilluar procedurat e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit. Ky projekt hyn në vitin 2023 për realizim. Projekti është me vlerë rreth 450.000.00 € nga buxhetet e tri fakulteteve (FN, FIEK dhe FIM).
- Janë zhvilluar procedurat e tenderimit dhe është nënshkruar kontrata për pajisjet laboratorike të strukturave në vlerë 150,000.00€. Realizimi i furnizimit me pajisje pritjet të bëhet gjatë vitit 2023.
- Laboratori i Hidroteknikës përkatësisht Inxhinierisë së Ambientit i fituar nga FN për programin e studimeve MSc në MIRU (IWRM) për rinovimin e hapësirave dhe i pajisur me pajisje për nevojat e studentëve salla me kompjuter në vlerë rreth 150,000.00€.
- Ka filluar hartimi i projektit për renovimin e katit të pestë. Sallat e mësimin, korridoret, hapësirat tjera përcjellëse të cilat duhet të trajtohen duke realizuar një projekt shumë ambicioz.

- Donacione për FN nga kompanitë vendore, materiale konkretizimi, qasje në platforma elektronike për nevojat e gjeodezisë, shërbime të ndryshme në printime, transporte, shërbime teknike – dyer, ngjyrosje etj. në vlerë të përafërt rreth 15,000.00€.

3.7 Puna e FN me palën e tretë

Stafi akademik i FN-së ka qenë i angazhuar në shërbime profesionale për palën e tretë, përkatësisht institucioneve gjyqësore të Kosovës duke bërë vlerësime dhe ekspertiza profesionale. Janë gjithsej 8 lëndë gjyqësore për të cilat janë përcaktuar mësimdhënësit e fushave përkatëse, ku për secilën lëndë janë emëruar tre mësimdhënës.

Shërbime profesionale për Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, vlerësimi i objekteve të Teatrit Kombëtar të Kosovës dhe vlerësimi i Muzeut Kombëtar të Kosovës.

Shërbime profesionale për Ministrinë e Shëndetësisë, vlerësimi i objektit ekzistues të spitalit rajonal të Ferizajt, faza e strukturës së ndërtuar.

Shërbime profesionale për Komunën e Gjakovës, vlerësimi i urës automobilistike në fshatin e Rogovës, komuna e Gjakovës.

Dekani i Fakultetit të Ndërtimtarisë,

Prof.ass.Dr. Florim Grajçevci

